



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 1 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesat e Veselit për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar
të Fjalëve**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 39(1) dhe (13) dhe 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 9(5)(a) dhe (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), dhe nenet 36(1) dhe (2) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),² nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 28 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin për paraqitjen e parashtrimeve nga Hashim Thaçi mbi faktin nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim, dhe më tej gjykoi se edhe të akuzuarit e tjerë në këtë çështje mund të kërkonin ndryshim të të njëjtit afat deri më 31 maj 2021.³
2. Më 31 maj 2021, Kadri Veseli (“z. Veseli”) dorëzoi një kërkesë për ndryshim të afatit të lartpërmendur deri më 4 qershor 2021, për të dhënë informacion shtesë në mbështetje të parashtrimeve të tij (“Kërkesa për Ndryshim Afati”).⁴ Gjithashtu, z. Veseli hoqi dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit të tij para përfundimit të afatit dymujor, të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe në rregullën 57(2) të Rregullores.⁵
3. Më 1 qershor 2021, z. Veseli dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve sipas nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, për të bërë parashtrime prej jo më shumë se 7500 fjalësh lidhur me vazhdimin e paraburgimit të tij (“Kërkesa për

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC-BD-15), 17 maj 2019.

³ KSC-BC-2020-06, F00327, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën Shtesë të Thaçit për Zgjatje Afati*, 31 maj 2021, publik, para. 9-11.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00331, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Afatit*, 31 maj 2021 (vënë në dispozicion më 1 qershor 2021), publike, para. 1-3.

⁵ Kërkesa për Ndryshim Afati, para. 4.

Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve”).⁶ Sipas z. Veseli, ekzistojnë rrethana të posaçme për ndryshimin e kërkuar pasi, pas përmbylljes së procesit të nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores, ai tani do të jetë në gjendje të trajtojë kriterin e “dyshimit të bazuar”, sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, të bëjë komente mbi shkallën e redaktimeve të bëra dhe të paraqesë shembuj të sjelljes së tij që mund të mbështesin zbutjen e faktorëve të rrezikut.⁷ Z. Veseli bën gjithashtu të ditur se ka marrë informacione të tjera në lidhje me kushtet për lirim.⁸ Ai më tej parashtron se nuk ka ndonjë afat për paraqitjen e parashtrimeve që kanë lidhje me rishikimin e paraburgimit.⁹ Z. Veseli gjithashtu pretendon se ekzistojnë arsye bindëse për këtë, pasi ndryshimi i kërkuar është i vogël dhe është e rëndësishme që ai të shterojë të gjitha argumentet e mundshme në lidhje me rishikimin e paraburgimit të tij.¹⁰ Së fundi, sipas tij, Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) nuk do t’i shkaktohet padrejtësi nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton kërkesën lidhur me ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve pa marrë më parë përgjigjen e ZPS-së.¹¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores përcaktojnë se, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00332, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 1 qershor 2021, publike.

⁷ Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 8.

⁸ Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 10.

⁹ Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 12.

¹⁰ Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 13.

¹¹ Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 14.

6. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese ose mbrojtësit të viktimave, lejohet që vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve të merret duke mos u dhënë atyre mundësinë e shprehjes së mendimit.
7. Sipas nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, mocionet nuk duhet të përmbajnë më shumë se 6000 fjalë.
8. Sipas nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës mund të kërkojë mjaftueshmërisht në kohë tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve duke treguar se ekzistojnë arsye bindëse që përbëjnë rrethana të posaçme.
9. Sipas nenit 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, mocioni për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa u dhënë atyre mundësinë për t'u shprehur.

III. DISKUTIM

10. Pasi shqyrtoi arsyet e paraqitura nga z. Veseli, konkretisht faktin që ai është duke marrë informacione shtesë në mbështetje të parashtrimeve të tij në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, dhe se ka hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit të tij para kalimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë dhënë arsye bindëse që përlligjin ndryshimin kërkuar të afatit. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon z. Veseli të dorëzojë parashtrimet e tij deri më 4 qershor 2021.
11. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është vërtetuar se ka arsye bindëse, të cilat përbëjnë rrethana të posaçme, që përlligjin ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve, duke pasur parasysh numrin dhe rëndësinë e çështjeve që z. Veseli synon të paraqesë në kuadër të parashtrimeve lidhur me vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim. Gjykatësi i Procedurës paraprake është gjithashtu i

mendimit se Kërkesa për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve është dorëzuar në kohë të mjaftueshme, përkatësisht tri ditë pune para afatit të ndryshuar lidhur me këto parashtrime. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon z. Veseli të dorëzojë parashtrimet e tij prej jo më shumë se 7500 fjalësh.

12. Duke marrë parasysh që ndryshimet e kërkuara janë të kufizuara, nxjerrja e këtij vendimi para marrjes së përgjigjeve të ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave në lidhje me kërkesat në shqyrtim, nuk u shkakton ndonjë padrejtësi këtyre të fundit.

IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën për Ndryshim të Afatit;
- b. **MIRATON** Kërkesën për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve; dhe
- c. **URDHËRON** z. Veseli që deri të **premtën, 4 qershor 2021**, të dorëzojë parashtrime prej jo më shumë se 7500 fjalësh lidhur me atë nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 1 qershor 2021

Në Hagë, Holandë.